


Amaneti i Prenk Grudës

Këtë intervistë e kam zhvilluar në shtëpinë e Prenkë Grudës, në Florida, pak ditë para se të mbyllte shtëpi. Nuk e shpreh dot me fjalë gjendjen time emocionale të asaj dite. Prenka u tregua më i fortë se unë. Ashtu i sëmurë, siç ishte, më tha se do të shkonim diku që ai të më tregonte një gjë të rëndësishme. Më ftoi në makinën e tij, të cilën nga gjendja e rëndë shëndetësore që po kalonte, kishte javë që nuk e kishte ndezur, dhe u nisën. Ndaloj diku pranë derit. Dolëm jashtë. Më tha se shpesh kur mërzitez vinte në atë cep dhe fliste me detin. Por nuk ishte ajo gjëja e rëndësishme që do të më tregonte. Ajo që më tregoi ishte kjo: "Gjekë", tha ai duke bërë me dorë nga deti, "shikoje detin! Nuk është i turbullt, sepse është shumë i thellë. Cektësia i turbullon gjërat. Matu me detin kur shkruan, kur interviston, dhe kur komunikon me njerëzit. Duaje njeriun dhe Shqipërinë sa do ky det bregun e vet. Ky është peshqeshi im që kam përt".



Prenkë Gruda dhe bashkëshortja e tij, Ana



Ditari i një zemre të lendueme i përkthyer nga Peter Prifti, editor Gjek Marinaj dhe i botuar në SHBA nga Marinaj Publishing 2000



Prenk Gruda së bashku me Gjekë Marinaj, në Florida, pranë shtëpisë së Prenkës, pas intervistës, një muaj para se i ndjeri të shkonte nga kjo jetë.

nga Gjekë Marinaj

Pyetje: Libri juaj "Ditari i një zemrës së lëndueme" ka fituar respek te lexuesi i kualifikuar. Mirëpo disa nga kundërshtarët tuaj nuk e pranojnë atë si një ditar të shkruar me singeritet. Cili do të ishte reagimi juaj ndaj këtij kontrastit?

P. Gruda: Unë kënaqem shumë duke menduar se me të vërtetë qëllimi im është plotësuar nga që ka qenë një qëllim konstruktiv nga e mira dhe e mira në shërbim të shqiptarizmit. Me kënaqet zemra kur njerëzit çmojnë. Kur veprë konsiderohet të jetë e vlefshme nga pikpamja historike dhe letrare, me kënaqet zemra. Kjo më bën të besoj se ia' kam arritur pak a shumë qëllimit, ngaqë gjithmonë mendja dhe zemra ime kanë qenë që t'i shërbej çështjes shqiptare. Kur është fjala për ata që janë kundra ditarit, mund të them se arsyet janë të shkruara në ditar. Ata i ka lënë histori e punët e tyre të pakënaqur me vete dhe jo ditari im. Por, ashtu siç kam pasur të drejtë unë të them mendimet e mia për ta, edhe ata kanë të drejtë të thonë mendimet e tyre përlibrin tim.

Pyetje: Iniciativa për ta shkruar

këtë ditar ka qenë personale apo ishte sygjerim i mësuesve tuaj të asaj kohe?

P. Gruda: Jo. Unë e shihja se harroheshin gjërat. Kisha lexuar në një libër të një shkrimtarit italjan, që vaujetet e njerëzve dhe të kombeve nuk duheshin harruar kurrë. Ai sugjeron se dikush duhet të mbante shënimë edhe në qoftë se aftësitë përtë shkruar nuk ishin të nivelit më të lartë. Kështu, tamam në ditën e vitit të ri, 1937, fillova punën. Ishte më tepër një protestë ndaj vetes. Ç'të mira do të sillte festimi i Vittit të Ri, kur nuk shiheshin askund përparrime shoqërore, mbarëvajtje ekonomike, zhvillimi i shkollave etj. Në atë kohë jetonim të njëjtën monotoni. Në bisedat e ditës nuk dëgjoje asgjë tjetër veç: Mbreti, Pallati Mbretëror, ...në la mbraja Turqia etj. Askush, nga ana tjetër, nuk bënte gjë për ndryshimin e gjendjes. Kështu unë vazhdova punën. Shëmimet që mba ja mbetën të pa shtypura në makinen shkrimi për shumë kohë. Shkruaja me shpresën se një ditë do e shihnin drithën e botimit.

Pyetje: Nisur nga bisedat telefonike që kemi pasur me ju, nga artikujt e shumtë që keni botuar në organet e ndryshme të shtypit, intervistat etj, kam krijuar mendimin se njeriu shqiptar është gjëja më e

rëndësishme në botën tuaj. Si e shpeshi gjegjoni këtë dashuri kaq të madhe që ushqeni për shqiptarin?

P. Gruda: Mendoj se dashuria përkombin është një vityt i shumicës së shqiptarëve. Unë kam mësuar shumë gjatë kohës që kam jetuar në Beograd. Për ato dy vjet, unë kam parë se serbët e duan shumë Serbinë edhe bëjnë shumë për njëri-tjetrin. Kurse ne shqiptarët duhet të bëjmë edhe më shumë, sepse kemi jetuar të përçarë dhe me halle, mot mbas moti, që në kohën e Turqisë. Ne duhet të bëjmë gjithçka për Shqipërinë dhe shqiptarët. Nuk po them që kjo të bëhet në dëmin e dikujt tjetër, të një kombi tjetër. Por kur është mundësia të heqim diçka nga vetja për të ndihmuar të tjerët, nuk duhet të mendojmë shumë, por ta kryejmë këtë veprim me kënaqësinë më të madhe. Pra dashuria përkombin, mendoj se edhe mua, më ka ardhur si trashëgimi nga prindërit dhe kultura kombëtare që kemi.

Pyetje: Flamuri Kombëtar është gjëja kryesore në identifikimin e një kombi. Ju disa herë e keni shprehur pakënaqësinë tuaj në lidhje me historinë e ngritisë së flamurit në Vlorë. Pse është kaq e rëndësishme se ku është ngritisur flamuri më parë, ngaqë Vlora është në Shqipëri dhe se flamuri që u ngrit në këtë qytet të lashtë ishte shqiptar?

P. Gruda: Ngiritja e flamurit në Vlorë, edhe përmësuar si përtë gjithë shqiptarët, është një ngjarje e rëndësishme historike. Ajo që më shqetëson mua është se flamuri është ngritisur më parë në malet e Deçiqit, gjatë Kryengritjes së Malësisë së Madhe të vitit 1911. Pra historianët duhet të jalin të gjitha faktet kur shkruajnë për historinë e ngritisë së flamurit.

Që flamuri të ngritej në Vlorë u desh gjakderdhje në Veri. Këtë nuk duhet ta harrojnë kurrë as historianët as shqiptarët.

Pyetje: Parashikimet për të ardhmen, të kthehem edhe një herë te ditari juaj, përbëjnë një nga pikat kulminante të aftësisë suaj. A keni ndonjë vizion për të ardhmen e Shqipërisë dhe të shqiptarëve?

P. Gruda: Koha nuk do të përsëritet më as për ne shqiptarët. Deri tanë historia ka provuar se të qenit shqiptar na ka sjellë probleme para Evropës e sidomos para Ballkanit. Krenaria dhe dashuria që kemi përkombin tonë na ka bërë halë në shtëpi e atyre që deshën ta fshijnë emrin e kombit tonë nga historia e kombeve të Evropës.

Por problemi më i madh që do të kenë shqiptarët në të ardhmen, përmendimin tim, është shumë më i madh se ai që përmenda më lart. E kam fjalën përvienien e shqiptarit

kundër shqiptarit. Ato që dëgjojmë sot; shqiptarët e Shqipërisë, shqiptarët e Maqedonisë, shqiptarët e Kosovës, shqiptarët e Veriut e të Jugut, të Amerikës etj., janë origjinali e një problemi shumë të madh në ballafaqimin e Shqiptarëve me të ardhmen. Po si more, ne na placi shtëpi(!), mund të shohim ndryshime midis shqiparëve, duke u bazuar se ku jetojnë?! Ne jemi vetëm një grusht popull, ne jemi ajo kafshata e mbetur që të huajt nuk arriti ta kapërdijenë. Shqiptari është shqiptar pavarësisht nga origjina e tyre gjeografike, fetare apo preferanca politike që kanë. Këtë pikë e shoh si pikën më të rrezikshme në të ardhmen tonë. Vetëm shqiptari mund ta shkatërrojë shqiptarin. Por lus zotin nga dita në ditë që unë të jem gabim në këtë parashikim.

Pyetje: Dhe tanë vjen pyetja e fundit, nga që nuk ndiheni mirë dhe nuk dua t'ju mundoj më gjatë. Eshtë pyetja më e vështirë që kam i bërë diku një jetë e jetën time. Para kësaj interviste ju pohuat se sëmundja e kancerit po ju mundon shumë dhe se doktorët kanë parashikuar se ju keni më pak se një muaj jetë. Çfarë do të thotë vdekje për ju? Sa e vështirë është që të jetosh me mendimin se çdo shkrepje sysh mund të jetë ajo e fundit për ju?

P. Gruda: Po edhe unë, siç e ka krijuar zoti, po vdes. Por kanë vdekur burra ma të mirë se unë. Vdekjes nuk ia kam frikën, se besoj në Zot. Asnjëherë në jetën time nuk i kam bërë keq, me dashje, askujt. Kur i kthej shtë mbrapa, ndoshta do t'i kisha ndryshuar disa gjëra, por kjo mund të jetë normale për të gjithë. Megjithëse familjen, miqtë e dashamirët i kam dashtë pa kufi dhe jam munduar të bëj gjithçka që ka qenë e mundur për t'i ndihmuar, ndoshta mund të kisha bërë edhe më shumë. Për shqiptarizëm nuk e kam kursyer veten kurrë. Nuk shkoj me zemrën të plasur në këtë drejtim. Meqë më krijoj mundësinë me këtë interviste, Gjekë, po ju la një amanet familjes, miqve dhe krejt shqiptarëve: Duajeni shumë njëri-tjetrin dhe Atdheun sa nuk është vonë. Zoti i bekofte të gjithë shqiptarët kudo që janë!

ALBA TRAVEL

2123 Williamsbridge Road, Bronx, NY 10461

ÇMIME SPECIALE DERI MË 31 Mars 2004

Me përfshirje të 14 Dec – 24 Dec, 2003.

NYC-TIRANË	\$600
NYC-PRISHTINË	\$565
NYC-SHKUP	\$565
NYC-SARAJEVË	\$540
NYC-ATHINË	\$640
NYC-SELANIK	\$645
NYC-VENECIA	\$600

Në të gjitha çmimet taksat janë të përfshira brenda, po kështu nuk ka pagesa ekstra përditë: e premte, e shtunë dhe e dielë. Tax is included in all the prices. No surcharge on weekends. Përmë se 10 vjet në shërbimin tuaj

Ju mirëprejt
Shpresa Uli

Tel. (718) 678 – 8800
Fax: (718) 678 – 8832

NJOTIM

Njoftojmë të gjithë të porsaardhurit në Amerikë si dhe ata që kanë ardhur këtu brenda një viti dhe kanë nevojë për orientim dhe informacione të ndryshme si përmësimin e gjuhës angleze, punësim e probleme të tjera, të drejtoshën në Organizatën Shqiptare-Amerikane "Motrat Qiriazi".

Motra të dashura, zonja të ndera, mos ngurroni të trokisni në derën tonë, e cila do të jetë porta e parë që do t'ju hapë rrugën drejt integrimit dhe suksesit tuaj në jetën e re, në jetën amerikane.

Ju rikujtojmë se së bashku do të jeni më të forta dhe më efektive. Ju mirëpresim në adresën 481 8-th avenue, Ste. 934, New York, 10001.

Përtakim na telefononi në (212) 244 – 8440.

Me respekt

Doktoresha Anna Kohen

Presidente e AAWO "Motrat Qiriazi"

